



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 29 janar 2024**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1874\_2024**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Mbështetur në Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Nenit 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Vendimin V\_1770\_2023 të datës 21 shtator 2023, Kërkesën e KOSTT SH.A. të pranuar nr. 015/24 të datës 05.01.2024 për Amendamentimin e Procedurave Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë;

**në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** - kërkesa me amendamentet e Procedurave Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë për Republikën e Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës.
- II. OBLIGOHET** – KOSTT Sh.A që të ndërmarr të gjitha veprimet që të zbatoj amandamentet si në dispozitivin e pikës I. të këtij vendimi

## **A r s y e t i m**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 05.01.2024 ka pranuar nga KOSTT SH.A. kërkesën për amendamentimin e Procedurës Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë.
  - ZRRE, ka vlerësuar propozimet për amendamentimin dhe ndryshimet e nevojshme si dhe shtesat në Procedurën Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë, dhe ka konsideruar se amendamentimet duhet të shqyrtohen dhe vendosen nga Bordi i ZRRE-se për miratim.
  - Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të amendamentimit të Procedurës Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë Shqipëri – Kosovë, ka konstatuar se kërkesa e KOSTT është e bazuar, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
  - IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Shtojcë:** -Amendamentet e Procedurave Rezervë për Bashkimin e Tregut të Energjisë Elektrike të Ditës në Avancë për Shqipëri – Kosovë.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
\_\_\_\_\_


Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
\_\_\_\_\_

Lutfije Dervishi, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Gani Buçaj, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Arta Isufi, anëtar

  
\_\_\_\_\_

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- KOSTT SH.A.,
- ALPEX, dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji